

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË SHIJAK. DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Shijak, Durrës**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 23, datë 25.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1075/06, datë 31.03.2014, i ka rekomanduar z. Indrit Buka, Kryetar i Bashkisë Shijak, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të hartohet plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, plani strategjik, të përcaktohen objektivat dhe hartohen plan veprimet afat shkurtër në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”.

Prill 2014

2. Të sigurohet zbatimi i procedurave lidhur me përgatitjen e hartimit të projekt buxheteve në kohë, në përmbushje të gjithë funksioneve, një evidentim i saktë vlerësimi të zbatimit të njëjtë të buxhetit vendor dhe qendror, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor*”.

Gusht 2014

3. Nga Zyra e Financës, të merren masa për azhurnimin e artikujve kontabël përmbledhës të ditave të kontabilitetit në librin përmbledhës të llogarisë ose në sistem. Të mos pasqyrohen në bilanc teprica llogarish të pa mbështetura në artikuj kontabël, dhe në rastet e paraqitjes të kryhet analiza e gjendjes teprice.

Vazhdimisht

4. Të merren masa nga Zyra e Financës dhe të sistemohet llogaria nr. 468, “*Debitorë në persona*”, duke azhurnuar artikujt kontabël për 8 (tetë) raste në shumën në **247,140 lekë në pakësim të inventarit kontabël**. Të sistemohet me artikull kontabël në inventar të llogarisë nr. 210, “*Toka troje e terrene*”, sipërfaqja e truallit **222.7 m²** që i përket tregut “*Fruta e perime*” në Xhafzotaj **me vlerë 491,000 lekë**, sipas urdhër pagesës nr. 19, datë 25.02.2005.

Prill 2014

5. Të merren masa, nga Zyra e Financës, për sistemimin në kontabilitet me inventarë kontabël dhe inventarë fizik **të vlerës 82,564,460 lekë** si diferencë e pa analizuar në llogarinë nr. 213, “*Rrugë rrjete e vepra ujore, e trashëguar që nga viti 2007 nga ish- Ndërmarrja Rrugë Kanalizime pa inventarë fizik dhe inventarë kontabël (trajtuar në faqen nr. 24 të Raportit të Auditimit)*”.

Prill 2014

6. Nga Zyra e financës të kryhen veprimet në kontabilitet për regjistrimin në llogarinë përkatëse nr. 218, “*Inventarë ekonomik*” të orendive e pajisjeve të përfshira gabimisht në llogarinë nr. 214 “*Instalime teknike makineri e pajisje e vegla pune*”, duke kryer njëkohësisht dhe analizën e gjendjes së tyre.

Prill 2014

7. Nga Bashkia Shijak të merren masa të ndërpriten rastet e pagesave nga arka, pa kaluar nëpërmes degës së thesarit, sipas kërkesave të nenit 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor*”.

Menjëherë

8. Bashkia Shijak, në bashkëpunim me strukturat shtetërore përkatëse të ndërmarrë veprimet e duhura ligjore për saktësimin e gjendjes juridike me ZVRPP, bërjen e korrigjimeve, inventarizimin e gjendjes

dhe pronësinë e pasurive të përfshira në listat e VKM nr. 839, datë 22.07.2009. “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose Përdorim, të Bashkisë Shijak të Qarkut të Durrësit”, si dhe të verë nën administrim dhe efikasitet pasuritë, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Brenda muajit Maj 2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjyqimit e ato përmbarimor, me qëllim shpërblimin e dëmit me vlerën: **14,090,650 lekë**, si më poshtë:

1. Vlera 1,420 mijë lekë për 56 subjekte, të cilët ushtrojnë aktivitet dhe janë të paregjistruar në QKR gjatë vitit 2013 dhe të pa kontabilizuar.

Qershor 2014

2. Vlera 797 mijë lekë F.K. në cilësinë e agentit tatimor për menaxhimin e tregut publik, për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve sipas aktmarrëveshjes lidhur midis palëve datë 12.04.2012 me afat deri datë 12.04.2014, i pa regjistruar si detyrim (*trajtuar në faqen nr. 42, të Raport Auditimit*).

Mars 2014

3. Vlerën 398,650 lekë E.O. në cilësinë e juristes, L.B. dhe z. I.D. në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për shkak të përcaktimit të gabuar të llojit të procedurës së prokurimit nga tender për “Blerje mallrash” në tender për “Punë publike”, me efekt skualifikimin e operatorit ekonomik me vlerë më të ulët në tenderin me objekt “Mbjellje pemësh dekorative, për gjelbërimin e qytetit Shijak”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 3, pika 6, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë.

Korrik 2014

4. Vlerën 112,500 \$, ose e konvertuar 11,475 lekë, nga e cila R.K. 5,737,500 lekë dhe D.H. 5,737,500 lekë, pasi nuk kanë shlyer detyrimet sipas aktmarrëveshjes së qirasë lidhur datë 27 Shkurt 2006, me objekt tregun “Fruta perime” në Xhafzotaj, me sipërfaqe 2495 m².

Brenda vitit 2015

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 25, pika 3, shkronjat “a,b,ç,” të ligjit nr 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”; pikën 1, shkronjat (b) dhe (ë), të vendimin e KM nr. 306, datë 13/6/2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, si dhe kontratave individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore: **“Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, qerma b**

1. B.D. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Tatim Taksave.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos realizim të taksave e tarifave vendore për vitin 2012 dhe 2013.
- Për mos kompletim të dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm ligjorë në llogaritjen e detyrimeve vjetore.
- Për mos aplikim sanksione për vonesë e shkelje afati të pagesës së kësteve tatimore ndaj subjekteve të biznesit të madh dhe të vogël.
- Për zbatim të procedurave ligjore, lidhur me mos-rakordimin me Drejtorinë Rajonale të Tatimore Durrës për biznesin e madh, me Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor për taksën e regjistrimit automjeteve dhe ZVRPP Durrës, etj.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.5.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, me UMF dhe MB nr. 655/1, datë 6.02.2007, me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”, Rregulloren e Brendshme, Vendime të KB .

2. P.A. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Financës, për mangësi në mbajtjen e kontabilitetit, mungesën e azhurnimit të ditarit të veprimeve të ndryshme, kontabilizime të gabuara e të pa sistemuara ,mosrakordim të llogarive analitike me ato sintetike, mos azhurnimi i centralizatorit etj, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, neni 5.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit te detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Pal Daci, Mirosh Bogdo dhe Hektor Kosova, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT